

KËRKESË PËR OFERTA
Për shërbime përkthimi në kuadër të zbatimit të projektit

ToKeQark SB NI KOS 09/2023

Publikuar me: 26 tetor 2023

Afati i hapur për aplikim: 10 nëntor, 2023

1. Hyrje

The Balkan Forum kërkon të rekrutojë një kompani përkthimi/ apo ekip përkthyesish, të cilet do të ofrojnë shërbime të përkthimit për aktivitetet e projektit ToKeQark si përshkruhen në vijim:

Projekti "ToKeQark" SB NI KOS 09/2023 ka si qëllim parësor promovimin e qëndrueshmërsisë mjedisore dhe zbutjen e ndryshimeve klimatike duke i trajtuar sfidat mjedisore përmes përfshirjes së komunitetit/palëve në diskutim, si dhe të ofrojë informata të përditësuara lidhur me tranzicionin drejt ekonomisë qarkore në Kosovë e në veçanti, në katër komuna të Kosovës: Ferizaj, Fushë Kosovë, Graçanicë dhe Mitrovicë. Projekti financohet nga SMART BALKANS, i mbështetur financiarisht nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë (NMFA) dhe zbatohet nga The Balkan Forum.

2. Objektivat e shërbimit

Kompania apo ekipi i përkthyesve ofron përkthim cilësor të raportit hulumtues; b) ofron përkthime/interpretime cilësore konsektive apo simultane në eventet e organizuara dhe c) ofron paisje cilësore me çmim të arsyeshëm.

3. Shërbimet e kërkuara - Detyrat

3.1 Lektorimi i raportit/hulumtimit në shqip dhe në anglisht [raport i shkruar në shqip prej +/-20 faqesh]

3.2 Përkthimi i raportit nga gjuha shqipe në anglisht dhe serbisht

3.3 Përkthim në trajnim 3 ditor për 15 persona [nga shqip në serbisht]

3.4 Përkthim në trajnim 1 ditor për 15 persona [nga shqip në serbisht]

4. Periudha e Shërbimit

Shërbimet e përkthimit do të kërkojnë në periudhën nëntor– dhjetor 2023.

Aktiviteti / Shërbimi	Data
3.1 Lektorimi i raportit/hulumtimit në shqip dhe në anglisht [raport prej +/-20 faqesh]	Deri me 26 nëntor 2023
3.2 Përkthimi i raportit nga gjuha shqipe në anglisht dhe serbisht	Deri me 30 nëntor
3.3 Përkthim në trajnim 3 ditor për 15 persona [nga shqip në serbisht] + [paisje]	10-20 dhjetor
3.4 Përkthim në trajnim 1 ditor për 15 persona [nga shqip në serbisht] + [paisje]	Shkurt 2024

5. Buxheti i alokuar sipas projektit

Kategoria	Buxheti bruto [EUR]
Lektorimi i raportit në shqip dhe anglisht	300,00
Përkthimi i raporteve nga gjuha shqipe në anglisht dhe serbisht	600,00
Përkthim në trajnim 3 ditor për 15 persona [nga shqip në serbisht]	550
Përkthim në trajnim 1 ditor për 15 persona [nga shqip në serbisht]	550
Gjithsej	2000.00 EUR

6. Përvoja

Të interesuarit duhet të demonstrojnë se kanë përvojë në ofrim të shërbimeve:

- Mbi 5 vite përvojë në ofrim të shërbimeve të përkthimit.
- Certifikaten e regjistrimit të biznesit
- 2-3 referenca se për cilat organizata kanë përkthyer.
- Aftësi dhe kapacitete për të ofruar punë me cilësi të lartë, brenda kornizës kohore të cekur në pikën 4.

7. Të interesuarit duhet të dorëzojnë

- Ofertën që përmban emrat e përkthyesve ose cv.
- Oferten financiare dhe konfirmimin e kapacitetit për të ofruar shërbimet sipas kërkesës të specifikuar në pikat 3,4,5 të kësaj thirrjeje.

Procedura e aplikimit

Oferta dërgohet në email adresën dren@thebalkanforum.org & gazmend@thebalkanforum.org. Aplikimet që nuk përmbajnë dokumentet e kërkuara nuk do të konsiderohen për vlerësim.

Afati për aplikim është i hapur deri me datë 10 nëntor 2023.

Vetem kompanitë / ekipet përkthyesive që hyn në listë të ngushtë do të kontaktohen nga ekipi i The Balkan Forum